

# **L I G J**

**Nr. 8517, date 22.7.1999**

## **PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE**

Ne mbeshtetje te neneve 35, 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave

### **K U V E N D I**

#### **I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

#### **V E N D O S I:**

#### **KREU I**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Neni 1

Qellimi i ligjit

Ky ligj ka per qellim te garantoje mbrojtjen dhe perdorimin e ligjshem te te dhenave personale dhe trajtimin e tyre nga autoriteti publik.

Neni 2

Perkufizime

Termet e meposhtme do te kuptohen si vijon:

a) Me "te dhene personale" do te kuptohet çdo e dhene per nje individ te identifikuar ose te identifikueshem nga kjo e dhene ne menyre te drejtperdrejte apo te terthorte;

b) me "te dhene personale sensitive" do te kuptohen te dhena te tilla si:

- origjina racore dhe etnike, bindjet dhe perkatesite politike, bindjet fetare dhe te tjera;

- gjendja shendetesore, jeta seksuale dhe gjendja penale;

c) me " trajtim te te dhenave" do te kuptohet çdo veprim i kryer me apo pa ndihmen e mjeteve elektronike, per mbledhjen, regjistrimin, organizimin, ruajtjen, perpunimin, modifikimin, seleksionimin, nxjerrjen, ballafaqimin, perdorimin, bllokimin, komunikimin,

shperndarjen, fshirjen, shkaterrimin, si dhe çdo veprim tjetër, të të dhënave;

ç) me "subjekt të të dhënave personale", do të kuptohet çdo individ, me të cilin lidhen të dhënat personale;

d) me "person përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale" do të kuptohet çdo person tjetër, i ngarkuar me akt normativ me trajtimin e të dhënave personale të të tjerëve;

dh) me "përdorues të të dhënave personale" do të kuptohet çdo individ, i ndryshëm nga subjekti i të dhënave personale dhe i autorizuar për trajtimin e tyre nga personi përgjegjës, për trajtimin e të dhënave personale;

e) me "të dhëna anonime" do të kuptohet çdo e dhënë, nëpërmjet së cilës nuk mund të identifikohet drejtpërdrejt apo terthorazi, ndonjë person;

e) me "publik" do të kuptohet të paktën një individ, vendas ose i huaj.

f) me "autoritet publik" do të kuptohen ato institucione shtetërore të përcaktuara, me të njëjtin term në ligjin nr. 8503, datë 30. 6. 1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

### Neni 3

#### Rregull i përgjithshëm

Publiku mund të njihet me të dhënat personale të një individi vetëm në mënyrën e masës së përcaktuar në këtë ligj.

### Neni 4

#### Perjashtimet

Nga veprimi i dispozitave të këtij ligji përjashtohen rastet e mëposhtme:

a) trajtimi i të dhënave personale nga vete subjekti i të dhënave;

b) trajtimi i të dhënave anonime;

c) të dhënat personale, të përfutuara gjatë hetimit ose zhvillimit të procesit gjyqësor;

ç) të dhënat e klasifikuara si sekret shtetëror;

d) trajtimi i të dhënave, me qëllim sigurimin kombëtar, parandalimin e krimeve dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

dh) trajtimi i të dhënave, me qëllim regjistrimin e popullsisë.

## KREU II

### TRAJTIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

## SEKSIONI I

### Kushtet per trajtimin e te dhenave personale

#### Neni 5

### Menyra e trajtimit te te dhenave personale

Trajtimi i te dhenave personale behet:

- a) ne menyren e parashikuar nga ky ligj;
- b) me nje qellim te percaktuar, te qarte dhe legjitim;
- c) ne menyre te sakte dhe mbi bazen e te dhenave te azhornuara;
- ç) pa e tejkaluar qellimin per te cilin ato trajtohen dhe jo per me shume kohe nga ç'eshte e nevojshme per realizimin e qellimit te trajtimit;
- d) duke krijuar kushte, qe i ruajne nga demtimet;
- dh) duke perdorur vetem ato te dhena qe kane rendesi dhe qe jane te nevojshme per realizimin e qellimit te trajtimit.

#### Neni 6

### Njoftimi i subjektit te te dhenave

Subjekti i te dhenave njoftohet paraprakisht para fillimit te mbledhjes se te dhenave personale nga personi pergjegjes per trajtimin e te dhenave per:

- a) emrin dhe adresen e personit pergjegjes per trajtimin e te dhenave, si dhe te personave te tjere, qe trajtojne te dhenat;
- b) qellimin apo qellimet e trajtimit te te dhenave;
- c) kategorine apo kategorite e te dhenave qe trajtohen;
- ç) personat apo kategorite e personave qe perdorin te dhenat;
- d) mundesine e levizjes se ketyre te dhenave ne nje vend te trete;
- dh) plotesimin e kushteve te sigurise se trajtimit te te dhenave.

#### Neni 7

### Personi pergjegjes per trajtimin e te dhenave

Per te siguruar te gjitha garancite ligjore ne trajtimin e te dhenave personale, personi pergjegjes per trajtimin e te dhenave dhe çdo person tjeter qe merret me trajtimin e tyre, duhet te jete nje person me pervoje ne trajtimin e te dhenave, me integritet te larte moral dhe me aftesi teknike, qe garantojne sigurine e te dhenave.

## Neni 8

### Persona te tjere qe trajtojne te dhenat personale

Çdo person tjetër, qe trajton te dhenat personale, duhet te jete i autorizuar me shkrim nga personi pergjegjes per te dhenat, perveç rasteve kur trajtimi i tyre kerkohet me ligj.

Personat e tjere, qe merren me trajtimin e te dhenave, duhet t'u permbahen te gjitha rregullave te percaktuara nga personi pergjegjes per te dhenat.

Personi i autorizuar, per trajtimin e te dhenave personale, nuk mund t'ia transferoje keto te dhena nje pale te trete.

## Neni 9

### Siguria ne trajtimin e te dhenave

Personi pergjegjes per te dhenat personale duhet te marre te gjitha masat teknike dhe organizative, per mbrojtjen e ketyre te dhenave nga çdo demtim apo rast humbjeje, te paligjshme apo aksidentale, nga çdo ndryshim, akses apo perhapje te paautorizuar, sidomos ne rastet kur trajtimi i tyre behet ne forme elektronike ne rrjet, si dhe kunder çdo lloj forme tjetër trajtimi te paligjshem.

Ne rastin e te dhenave personale sensitive, marrja e ketyre masave duhet t'i pergjigjet nivelit te rreziqeve te trajtimit dhe natyres specifike te ketyre te dhenave.

## SEKSIONI II

### TE DREJTAT E SUBJEKTIT TE TE DHENAVE

## Neni 10

### Kushti i pelqimit paraprak

Trajtimi i te dhenave personale nga persona te tjere lejohet vetem ne rast se subjekti i ketyre te dhenave ka dhene, shprehimisht, pelqimin per kete trajtim.

Pelqimi paraprak mund te jepet per te gjithë procesin e trajtimit ose vetem per nje apo disa elemente te ketij procesi.

Pelqimi paraprak eshte i vlefshem vetem ne qofte se ai eshte dhene lirisht ose ne qofte se subjekti i te dhenave eshte njoftuar sipas nenit 6 te ketij ligji.

Per trajtimin e te dhenave personale sensitive, pelqimi paraprak eshte i vlefshem vetem nese ai eshte dhene me shkrim.

Neni 11

Rastet kur nuk eshte i domosdoshem pelqimi paraprak

Pelqimi paraprak i subjektit te te dhenave nuk eshte i domosdoshem kur plotesohet nje nga kushtet e meposhtme:

- a) Kur trajtimi eshte i nevojshem per permbushjen e nje kontrate, ku subjekti i te dhenave eshte pale, ose per kryerjen e veprimeve paraprake, per hyrjen e tij ne nje marredhenie kontraktore;
- b) Kur trajtimi eshte i nevojshem per permbushjen e nje detyrimi ligjor te vete subjektit te te dhenave;
- c) Kur behet fjale per te dhena te marra nga regjistra publike, nga lista, akte ose dokumente te njohura publikisht nga te gjithet;
- ç) Kur trajtimi eshte i nevojshem per ruajtjen e jetes dhe te integritetit fizik te subjektit te te dhenave personale ose te nje personi fizik te trete, me kusht qe pelqimi i subjektit te te dhenave personale eshte i pamundur, per shkak te nje pamundesie fizike, per shkak te mungeses se aftesise per te vepruar ose ne rast se ai eshte i papergjegjshem;

Neni 12

E drejta per t'u njohur me te dhenat personale

Çdo person ka te drejte te njihet ne çdo kohe me procesin e trajtimit te te dhenave te tij personale. Personi pergjegjes per trajtimin e te dhenave, si dhe çdo person tjetër i perfshire ne trajtimin e te dhenave personale, eshte i detyruar qe, brenda 10 ditesh nga dita e depozitimit te kerkeses per informacion, t'i siguroje subjektit te te dhenave informacionin e kerkuar.

Neni 13

E drejta e subjektit te te dhenave per te kundërshtuar trajtimin

Ne te gjitha rastet, pervec atyre te parashikuara ne nenet 4 dhe 10 te ketij ligji, subjekti i te dhenave mund te kundërshtojë trajtimin e çfaredolloj te dhene te tij personale.

Kushdo ka te drejte te kerkoje ndreqjen ose fshirjen e te dhenave te paverteta, te paplota ose te mbledhura ne kundërshtim me ligjin. Personi pergjegjes per trajtimin e te dhenave i pergjigjet me shkrim kerkeses se subjektit te te dhenave brenda 15 diteve nga dita e berjes se kerkeses, qe kundërshton trajtimin e te dhenave.

Ne rast se personi pergjegjes, per trajtimin e te dhenave personale, nuk pranon kerkesen e subjektit te te dhenave per korrigjimin e tyre, atehere te dhenat e paraqitura nga subjekti i ketyre te dhenave, i bashkelidhen te dhenave te poseduara nga personi pergjegjes dhe i bashkeshoqerojne ato ne çdo rast te trajtimit te tyre.

Neni 14

Transferimi i te dhenave personale jashte shtetit

Te dhenat personale mund te trasferohen te nje perdorues i huaj, jashte Republikes se Shqiperise, vetem ne rastet e meposhtme:

- a) kur eshte dhene me shkrim pelqimi i subjektit te te dhenave;
- b) kur nje gje te tille e lejon ligji;
- c) kur juridiksioni ne te cilin vepron personi i huaj, pergjegjes per trajtimin e te dhenave personale, ofron te njejtat garanci qe ofron ky ligj ne trajtimin e tyre.

KREU III

ANKIMI

Neni 15

Ankimi tek Avokati i Popullit

Ankimi tek Avokati i Popullit dhe kompetencat e tij ne fushen e te dhenave personale rregullohen nga ligji nr. 8454, date 4. 2. 1999 "Per Avokatin e Popullit".  
Avokati i Popullit krijon nje regjister te trajtimit te te dhenave personale.

Neni 16

Rregull i pergjithshem

Shkelja e dispozitave te ketij ligji, per aq sa nuk perben veper penale, perben kundervajtje administrative dhe rregullohet ne baze te ligjit nr. 7697, date 7. 4. 1993 "Per kundervajtjet administrative", me ndryshimet dhe plotesimet e nevojshme.

Neni 17

Ankimi administrativ

Çdokush ka te drejte te ankohet ne rruge administrative, kur e gjykon se i jane shkelur te drejtat e parashikuara nga ky ligj.  
Procedurat e ankimit administrativ rregullohen me ligj.  
Neni 18

Ankimi gjyqesor

Çdokush ka te drejte te ankohet ne rruge gjyqesore, kur gjykon se i jane shkelur te drejtat e parashikuara nga ky ligj.  
Procedurat e ankimit gjyqesor rregullohen me dispozitat e Kodit te Procedures Civile per gjykimin e mosmarreshjeve administrative.

Neni 19

Shperblimi i demit

Çdokush ka te drejte te kerkoje shperblimin e demit nga subjektet qe shkelin te drejtat e njohura nga ky ligj, kur shkelja ne fjale shkakton dem.  
Procedura per pretendimin dhe dhenien e shperblimit te demit rregullohet me ligj.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 20

Marrja e masave tekniko-administrative per zbatimin e ketij ligji

Te gjitha subjektet, veprimtaria e te cilave, teresisht ose pjeserisht, ka lidhje me trajtimin e te dhenave personale, brenda gjashte muajve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, marrin te gjitha masat tekniko-administrative per pershtatjen dhe rregullimin e veprimtarise se tyre ne perputhje me kete ligj.

Neni 21

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi 4 muaj pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2432, date 28.7.1999 te Presidentit te  
Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani